



Federata Aeronautike e Kosovës

Në pajtim me statutin e Federatës së Aeronautike të Kosovës, bordi i Federatës Aeronautike të Kosovës në mbledhjen së vet të datës 15.03.2017 nxorri këto vendime:

VENDIMET 2-2017

Vendimi 2.1 Gjendja financiare

2.1.1 - Bordi i FAK nxorri vendim që nga borxhi aktual i FAK (në total 11,000.00 EUR) ndaj huadhënësve/anëtarëve të bordit të saj, vetëm shuma prej 1,000.00 EUR t'i kthehet njërit nga huadhënësve, ndërsa pjesa tjetër prej 10,000.00 EUR të mbetet si huamarrje nga FAK dhe shfrytëzohen për mbarvajtjen e rregullt të operacioneve të FAK.

2.1.2 - Të ekzekutohet pagesa prej 3,100 EUR për anëtarësinë vjetore të FAK në FAI për vitin 2017.

2.1.3 - Të ekzekutohen pagesat e hapura ndaj furnitorëve të FAK, si dhe të riimbursohen shpenzimet për ekzaminimin mjekësor për kandidatet femra për pilote (3 candidate).

Vendimi 2.2 Dokumentacioni i klubeve

Bordi nxorri vendim që klubeve të cilët nuk i kanë dorëzuar formularët e plotësuar dhe të nënshkruara për regjistrim dhe transferim të pilotëve në FAK deri më datën e caktuar më parë (28.02.2017) ti jepet afat që këtë ta bëjnë më së voni deri më 31.03.2017.

Vendimi 2.3 Definimi i shkallës së përkrahjes së pilotëve sipas rezultateve në garat ndërkombëtare

Bordi duke dashur të arrij menaxhim më efikas të buxhetit të sajë si dhe të inkurajoj garën edhe në mes të pilotëve të FAK, nxorri vendim dhe definoi shkallën e përkrahjes të pilotëve në bazë të rezultateve të arritura të pilotit, kjo gjithmonë duke u bazuar në rezultatet dhe rankimin sipas FAI.

Shkalla e përkrahjes financiare të pilotit pjesëmarrës në garë ndërkombëtare u definua si në vijim:



Federata Aeronautike e Kosovës

- 5 pilotët Kosovar të rakuar në FAI (rankimi në momentin e vendimit për pjesëmarrje në garë) nga vendi parë deri në vendin e pestë për disiplinën përkatëse, të përkrahen financiarisht për pjesëmarrje në garë ndërkombëtare me mbulim prej 100% nga FAK.
- 3 pilotët Kosovar të rakuar në FAI (rankimi në momentin e vendimit për pjesëmarrje në garë) nga vendi gjashtë deri në vendin e tetë për disiplinën përkatëse, të përkrahen financiarisht për pjesëmarrje në garë ndërkombëtare me mbulim prej 50% nga FAK.
- 2 pilotët Kosovar të rakuar në FAI (rankimi në momentin e vendimit për pjesëmarrje në garë) nga vendi nëntë deri në vendin e dhjetë për disiplinën përkatëse, të përkrahen financiarisht për pjesëmarrje në garë ndërkombëtare me mbulim prej 30% nga FAK.
- Të gjithë pilotët Kosovar të rakuar në FAI (rankimi në momentin e vendimit për pjesëmarrje në garë) në vendet njëmbëdhjetë e sipër për disiplinën përkatëse, nuk përkrahen financiarisht nga FAK për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare, por ata janë të mirëseardhur për pjesëmarrje në secilën garë.

Ky vendim automatikisht shfuqizon rregulloren: RREGULLORJA 02/2015 - RREGULLORJA PËR HARTIMIN E RANGLISTËS SË FEDERATËS AERONAUTIKE TË KOSOVËS, DISCIPLINA PARAGLLAJDIZËM. Bordi kërkoi që sa më shpejtë që është e mundur të krijohet rregullorja e re e ranglistës së pilotëve dhe kjo rregullore plotësisht të bazohet në rankimin e FAI.

Gjithashtu bordi u dakordua që kjo strukturë e përkrahjes së pilotëve pjesëmarrës në garat ndërkombëtare të inkorporohet në rregulloren për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare sa më shpejtë që është e mundur.

Vendimi 2.4

Definimi i kritereve për garim në disiplinat e ndryshme të paragllajdizimit

Bordi nxorri vendim që për vitin 2017 të gjithë pilotët paragllajdistë të FAK të përcaktohen individualisht për disiplinën garuese primare dhe atë sekondare të tyre (Precizion, Distancë).

Sipas përcaktimit të pilotit FAK do të përkrahë financiarisht pilotin vetëm për disiplinën primare të tij/saj, ndërsa piloti mund të merr pjesë me mjete vetanake edhe në të gjitha garat tjera të disiplinës sekondare të tij/saj.



Federata Aeronautike e Kosovës

Vendimi 2.5

Emërimet e anëtarëve në disa komision të FAK

Bordi i FAK nxorri vendimin për emërimin e anëtarëve të komisioneve të saj:

Komisioni për paragllajdzëm diciplina precision

- Avni Kuçi, Kryetar
- Gëzim Statovci, Anëtar
- Alban Kurtishi, Anëtar

Komisioni për paragllajdzëm diciplina distancë

- Shkumbin Vula, Kryetar
- Ardall Celina, Anëtar
- Eduard Daci, Anëtar

Komisioni për aerodelim

- Arben Gjokolli, Kryetar
- Naser Daci, Anëtar
- Imri Musliu, Anëtar

Vendimi 2.6

Emërimet e anëtarëve në disa komision të FAK

Bordi i FAK vlerësoi që duhet të krijohet dhe nxorri vendim për krijimin e një komision për vlerësimin e aftësive bazike të kandidatit për pilot para se piloti të lajmërohet në AAC për licensim për pilot të paragllajdit. Komisioni për ciklin e licensimit për vitin 2017 përbëhet nga:

- Ardall Celina
- Artan Venhari
- Shkumbin Vula

Për vlerësim të këtyre pilotëve do të caktohet një datë në të cilën do të bëhet ky vlerësim dhe do të njoftohen të gjithë pilotët dhe instruktorët e tyre.



Federata Aeronautike e Kosovës

Ditën e vlerësimit piloti duhet ta ketë të nënshkruar nga instruktori i tij/saj formën se kandidati ka kryer me sukses kursin e trajnimit për fluturime me paragllajd, ka plotësuar orët e nevojshme të fluturimit si dhe plotëson kriteret e përcaktuara nga AAC për licensim.

Vendimi 2.7

Huazimi i pajisjeve matëse për garat e precizionit – Kampionati Botëror 2017, Vlorë

Bordi aprovoi kërkesën e Federatës Aeronautike Shqipëtare për huazim (pa pagesë) të pajisjeve primare matëse të FAK për garat në precision (Kampionati Botëror 2017, Vlorë) dhe u morr vendimi që ky huazim të zyrtarizohet me një kontratë në mes të FAK dhe FASH dhe të definohen kushtet dhe kriteret e pranimit dorëzimit si dhe të kthimit të pajisjeve.

Vendimi 2.8

Përcaktimi i shumës së kuotizimit për anëtarët e FAK për vitin 2017

Bordi nxorri vendim për tarifat e kuotizimit për vitin 2017 për anëtarët dhe pilotët e sajë.

Tarifat janë si në vijim:

- Anëtarësia vjetore për vitin 2017 për klubet: 60 EUR
- Tarifa vjetore për mbajtje valide të licenses FAI për pilotët: 20 EUR
- Anëtarësia vjetore për vitin 2017 për anëtarin/pilotin pa klub: 250 EUR

Ky vendim parasheh që të gjitha obligimet e anëtarëve dhe pilotëve të kryhen më së voni deri më datën 30.04.2017

Vendimi 2.9

Regjistrimi i garuesëve në garat ndërkombëtare të diciplinës precision dhe distancë, paragllajdzëm

Bori i FAK u dakordua që deri në marrjen e vendimit nga MKRS për memorandumit e bashkëpunimit për vitin 2017 të mos ndahen/premtohen buxhete të sakta për asnjë aktivitet përveç atyre të rëndësisë strategjike për FAK.

Për pjesëmarrje në gara të ndryshme ndërkombëtare bordi i FAK u dakordua që komisionet përkatëse të të gjitha diciplinave të bëjnë përzgjedhjen e garave ndërkombëtare dhe të bëjnë



Federata Aeronautike e Kosovës

regjistrimin e pilotëve në këto gara, por me kusht që paraprakisht të informojnë pilotët që regjistrimi dhe shkuarja eventuale në garë duhet të mbulohet plotësisht me mjete vetanake të pilotit dhe më vonë në varësi së çfarë përkrahje financiare do të merr FAK nga MKRS për vitin 2017, FAK do të bëjë ndarjen e buxhetit. Në rast se buxheti i ndarë parasheh përkrahjen e garës e cila është mbajtur atëhere pilotët riimburohen për shpenzimet e bëra në bazë të shkallës së përkrahje (**Vendimi 2.3**).

Prandaj bordi autorizoi kryetarin e komisionit të paragllajdzimit (distancë), Z. Shkumbin Vula dhe kryetarin e komisionit të paragllajdzimit (precizion), Z. Avni Kuçi të fillojnë aplikimin dhe regjistrimin e pilotëve në gara, por paraprakisht t'i informoj ata për kushtet e pjesëmarrjes, mbulimin vetanak financiar për pjesëmarrje në garë si dhe mundësinë eventuale për riimbursim nga FAK sipas shkallës së definuar për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare, kjo gjithmonë nëse FAK ka fonde dhe nëse pjesëmarrja në ato gara aprovet nga bordi.

Vendimi 2.10

Gjiro Open 2017 – Paragllajdzim – distancë, përkrahja e pilotëve garues në këtë garë

Bordi nxorri vendim që të gjithë pilotëve pjesëmarrës në etapën e radhës së kampionatit kombëtar në paragllajdzim, diciplina distancë, që mbahet në Gjirokaster më 23.03.2017 – 26.03.2017 (Gjiro Open 2017), t'ju riimburohen nga 20.00 EUR për shpenzime të udhëtimit.

Vendimi 2.11

Shfrytëzimi dhe ruajtja e pajisjeve matëse për paragllajdzim, precizion

Bordi u morr vendim për lokacionin ku do të ruhet seti primar i pajisjeve matëse të paragllajdzimit, precizion, lokacioni tek Gjyqtari Xhelal Leskovci shkaku i hapësirës më të madhe në dispozicion dhe lokacionit në Prishtinë, si dhe përcaktoi kriteret për përdorim të pajisjeve/setit primar:

- Seti primar i pajisjeve matëse përdoret në të gjitha garat kombetare të cilat i organizon FAK
- Seti primar i pajisjeve matëse mund të përdoret në të gjitha aktivitetet tjera vetëm me aprovim paraprak nga bordi i FAK

Bordi u dakordua që seti sekondar i pajisjeve matëse të mbahet nga kryetari i komisionit për paragllajdzim, diciplina precizion, si dhe përcaktoi kriteret për përdorim të këtij seti:

- Seti sekondar i pajisjeve përdoret në të gjitha garat lokale (garat mujore) të cilat i organizon FAK dhe në të gjitha garat tjera të aprovuar nga FAK të cilat mund ti organizoj ndonjë klub



Federata Aeronautike e Kosovës

- Seti sekondar mund të përdoret në të gjitha aktivitetet tjera trajnuese në të cilët janë prezentë 5 e më shumë pilotë të licensuar si pilot paraglajdi.

Vendimi 2.12

Definimi i afatit kalimtar për regjistrim dhe transferim të pilotëve

Bordi i FAK nxorri vendim dhe përcaktoi afatin kalimtar për regjistrim dhe transferim të pilotëve në klube. Periudha prej 1 JANAR deri me 31 JANAR të vitit aktual u përcaktua si afati kur klubet bëjnë regjistrimet e pilotëve të rinjë si anëtarë të tyre në federate si dhe realizojnë dhe regjistrionjë transferet e pilotëve.

Prishtinë, 20.03.2017

Shkelqim Krasniqi
Kryetar i bordit të FAK